



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 30 prot.

Data 09.01.2023

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 01 datë 9.01.2023

**“PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT
/TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR PËR VITIN 2023”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika ç, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Vendimin Nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik-Tiranë”, grantin e akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit datë 06.01.2023, si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- Të miratojë detajimin fondeve të akorduara Universitetit Politeknik të Tiranës, në formë grant/transfertë e pakushtëzuar, për vitin 2023, sipas tabelës bashkangjitur.
- Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 108 / Prot.
11

Tiranë, më 17 / 01 / 2023

V E N D I M

Nr. 02, datë 17 . 01 . 2023

P Ë R

MIRATIMIN E LISTAVE TË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE PËRFITIM TË BURSËS FINANCIARE, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJEN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2022 – 2023

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 108 prot., datë 16.01.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 16.01.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe përfitim të bursës financiare, për vitin akademik 2022 - 2023, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2022 - 2023, sipas materialit bashkëlidhur.

3. Pagesa e bursave financiare për studentët që kanë aplikuar përpara datës 01.12.2022, të kryhet nga fillimi i vitit akademik. Për studentët që kanë aplikuar pas kësaj date, pagesa e bursës financiare të kryhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
4. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 330/1 Prot.

Tiranë, më 10/02/2023

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 03 datë 10.02. 2023

PËR

**MIRATIMIN E NUMRIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË BACHELOR
ME NOTË MESATARE 6 (GJASHTË) E LARTË, TË CILËT PËRFITOJNË
REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN
AKADEMIK 2022 – 2023 DHE EFEKTIN FINANCIAR**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 26.12.2018; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 330 prot., datë 07.02.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin prej 2257 studentë të ciklit të parë Bachelor me notë mesatare 6 (gjashtë) e lartë, të cilët përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2022 - 2023, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
2. Të miratojë efektin financiar që rrjedh nga zbatimi i Vendimit nr. 778, datë 26.12.2018 në shumën 35,352,500 (tridhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.
3. Ky vendim t’i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2023.

4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT
KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 547/ Prot.
14

Tiranë, më 15 /03 /2023

V E N D I M

Nr. 04 , datë 15 . 03 .2023

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 3, datë 06.03.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2022.
2. Të miratojë raportin e detajuar të buxhetit të konsoliduar për vitin 2023, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 662/2 Prot.

Tiranë, më 15 / 03 /2023

V E N D I M

Nr. 05, datë 15 . 03 .2023

PËR

**DETAJIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE TË AKORDUARA PËR
VITIN 2023**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr.926/1 prot., datë 17.02.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2023”, si dhe relacionin nr. 662/1 prot., datë 10.03.2023 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për detajimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2023 sipas tabelave bashkëlidhur në zërin:

- 606 (shpenzime për bursa të studentëve dhe pedagogëve).

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 662/3 Prot.

Tiranë, më 15/03 /2023

V E N D I M

Nr. 06, datë 15.03 .2023

PËR

**MIRATIMIN E NUMRIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË CILËT
PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT**

DHE

**NUMRIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË CILËT PËRFITOJNË
REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50% PËR VITIN
AKADEMIK 2022 – 2023, SI DHE EFEKTIN FINANCIAR**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 662 prot., datë 10.03.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin prej 40 studentësh të ciklit të parë, të cilët kanë plotësuar kriteret për përfitimin e bursës financiare gjatë vitit akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
2. Të miratojë numrin prej 70 studentësh të ciklit të parë, të cilët kanë plotësuar kriteret për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.

3. Të miratojë numrin prej 11 studentësh të ciklit të dytë, të cilët plotësojnë kriteret për reduktimin e tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
4. Për studentët që kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2022 – 2023, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
5. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2023.
6. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 686/1 Prot.

Tiranë, më 15/03 /2023

V E N D I M

Nr. 07, datë 15.03.2023

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 1246/7 prot., datë 05.08.2022 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të auditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Një kopje e raportit përfundimtar të miratuar, t’i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të Institucionit.
3. Ngarkohet Sektori i Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 686/2 Prot.

Tiranë, më 15/03 /2023

V E N D I M

Nr. 08 , datë 15.03 .2023

P Ë R

MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MEKANIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 1021/12 prot., datë 16.11.2022 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të auditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Një kopje e raportit përfundimtar të miratuar, t’i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të Institucionit.
3. Ngarkohet Sektori i Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 969/ Prot.
2

Tiranë, më 20 / 04 / 2023

V E N D I M

Nr. 10 , datë 20 . 04 . 2023

P Ë R

**MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNËS TË KRYERA JASHTË KOHËS
NORMALE TË PUNËS DHE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR, NGA PUNONJËSET E
SEKRETARIVE MËSIMORE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja ë, Udhëzimin nr. 10 datë 15.05.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, Urdhrin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 8, datë 30.06.2022 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022-2023”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Urdhrin nr. 61 datë 01.09.2021 të Rektorit të UPT – së “Për ndryshimin e orarit të punës të Sekretarive Mësimore gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 969/1 prot., datë 19.04.2023, Bordi i Administrimit i UPT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të punës dhe në ditët e pushimit javor nga punonjëset e sekretarive mësimore në periudhën shtator – nëntor 2022, për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve fitues në vitin akademik 2022 – 2023 në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas relacionit të administratorit dhe dokumentacionit shoqërues.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT
KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 770/1 Prot.

Tiranë, më 20/04 /2023

V E N D I M

Nr. 12, datë 20.04.2023

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË KARTËN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Statutin e UPT - së, neni 10, pika 2, shkronja l, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 770 prot., datë 24.03.2023 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë një shtesë në pikën II të Kartës së Auditimit të Brendshëm me përmbajtje sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI



Karta e Auditimit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës

Në pikën II “Objekti i kartës së auditimit të brendshëm”, shtohen:

Karta e Auditimit të Brendshëm është një dokument zyrtar i cili përcakton qëllimin, autoritetin, dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm brenda Universitetit Politeknik të Tiranës, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësive të auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm.

Llojet e shërbimeve të auditimit të brendshëm janë shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e këshillimit si më poshtë:

1. Një angazhim auditimi për shërbimet e sigurisë përfshin një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit të një njësie të UPT, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, auditimit të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit dhe lloje të tjera të auditimit të brendshëm.
2. Një angazhim këshillimi përfshin dhënien e këshillave dhe opinioneve, me qëllim shtimin e vlerës dhe përmirësimin e qeverisjes së UPT, përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut, në të cilat auditimi i brendshëm nuk ka përgjegjësi menaxheriale. Një angazhim këshillimi inicihet nga Bordi i Administrimit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 957/ Prot.
123

Tiranë, më 02 / 05 / 2023

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 13 , datë 02 . 05 .2023

PËR

**MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË
BACHELOR, PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI DHE NË
PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” DHE “MASTER
PROFESIONAL” NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2023 - 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 69, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës neni 52, pika 4 dhe neni 9, pika 3, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 7, datë 18.04.2023 të Senatit Akademik, shkresën nr. 957/20 prot., datë 20.04.2023 të Rektorit të UPT-së, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 957/22 prot., datë 27.04.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë Bachelor, në programin e integruar të ciklit të dytë, si dhe në programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2023 – 2024, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1272/1 Prot.

Tiranë, më 24/05 /2023

V E N D I M

Nr. 14, datë 24.05.2023

P Ë R

DETAJIMIN E FONDEVE BUXHETORE SHITESË TË AKORDUARA PËR VITIN
2023

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Vendimin nr. 748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar me vendimin nr. 243, datë 20.04.2023; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”; Shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8561/1 prot., datë 15.05.2023, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 1272 prot., datë 24.05.2023,

VENDOSI:

1. Detajimin e fondeve buxhetore shtesë të akorduara për vitin 2023 në shumën 91.000.000 (nëntëdhjetë e një milion) lekë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi në zërin:

- 600 (paga për punonjësit)

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULI

Anëtar
Voltisa KOÇI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1231/4 Prot.

Tiranë, më 24/05/2023

V E N D I M

Nr. 15, datë 24.05.2023

P Ë R

MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47; Vendimin nr. 748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar; Vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 17; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”; Vendimin nr. 14, datë 22.05.2023 të Senatit Akademik, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 1231/3 prot., datë 24.05.2023,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nivelin e pagave të personelit akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, në kufirin maksimal të përcaktuar për funksion/titull sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
2. Efektet financiare për miratimin e nivelit të pagës në kufirin maksimal, do të përballohen nga fondet në dispozicion të miratuara për vitin 2023.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 1 prill 2023.

BORDI I ADMINISTRIMIT



KRYETAR

Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1607/Prot.

Tiranë, më 17/07/2023

V E N D I M

Nr. 16, datë 17.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E NIVELEVE, KLASAVE DHE GRUPEVE TË POZICIONEVE TË
PUNËS, SI DHE MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE DHE SHITESAVE TË
TJERA MBI PAGË TË PERSONELIT ADMINISTRATIV DHE
NDIHMËSAKADEMIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe 67; Udhëzimin nr. 16, datë 16.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”; Vendimin nr. 4, datë 15.03.2023 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2022 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2023”; Vendimin nr. 27, datë 27.07.2022 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2023-2025 të Universitetit Politeknik të Tiranës”; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 1607 prot., datë 04.07.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelet, klasat, grupet e pozicioneve të punës, si dhe strukturën e pagës për personelin administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë shtesën e pagës për nivelin e kualifikimit, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë koeficientin e llogaritjes së vjetërsisë në punë për personelin ndihmësakademik dhe administrativ, sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë vlerat e shtesave të vështirësisë dhe dëmshmërisë në punë të punonjësve ndihmësakademik dhe administrativ, të përcaktuar në Klasën VII të lidhjes nr. 1, sipas lidhjes nr. 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 prill 2023.
6. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 969/3 Prot.

Tiranë, më 20/04 /2023

V E N D I M

Nr. 11, datë 20.04.2023

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË CILËT
PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT, NUMRIN E STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË TË
CILËT PËRFITOJNË REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN
50% PËR VITIN AKADEMIK 2022 – 2023, SI DHE EFEKTIN FINANCIAR

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 969 prot., datë 19.04.2023, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë numrin prej 2 studentësh të ciklit të parë, të cilët kanë plotësuar kriteret për përfitimin e bursës financiare gjatë vitit akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
2. Të miratojë numrin prej 2 studentësh të ciklit të parë, të cilët kanë plotësuar kriteret për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
3. Të miratojë numrin prej 1 studentit të ciklit të dytë, i cili plotëson kriteret për reduktimin e tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2022 - 2023, si dhe efektin financiar, sipas listës së paraqitur bashkëlidhur.
4. Për studentët që kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2022 – 2023, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.

5. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2023.
6. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2019/ Prot.

12

Tiranë, më 25/09/2023

V E N D I M

Nr. 20, datë 25.09.2023

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2024-2026 TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, paragrafi II, shkronja b; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”; si dhe Vendimin nr. 17, datë 08.09.2023 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026 të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 957/25 Prot.

Tiranë, më 25/09/2023

V E N D I M

Nr. 21, datë 25.09.2023

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja c; Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3; si dhe vendimin nr. 8, datë 18.04.2023 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2023 – 2024, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” me kohë të plotë, për vitin akademik 2023 – 2024 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2023 - 2024.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2023 – 2024.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.
9. Në situata objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara për pagesën e tarifës së shkollimit, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
10. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

K R Y E T A R

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2381/3 Prot.

Tiranë, më 30/10 /2023

V E N D I M

Nr. 22, datë 30.10.2023

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE TË
MINIERAVE, PËR ORGANIZIMIN E GRUPIT MËSIMOR NË VITIN E PARË TË
PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR "INXHINIERI E BURIMEVE
MINERARE" ME 5 (PESË) STUDENTË, PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin nr. 386, datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës; Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 27, pika 7; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës"; vendimin nr. 7, datë 13.10.2023 të Dekanatit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave; si dhe shkresën nr. 2381/1 prot. datë 19.10.2023 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, për organizimin e grupit mësimor në vitin e parë të programit të studimit Bachelor "Inxhinieri e Burimeve Minerare" me 5 (pesë) studentë, për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2149/2 Prot.

Tiranë, më 30/10 /2023

V E N D I M

Nr. 23, datë 30.10.2023

P Ë R

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR PERIUdhËN 2024 – 2026

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja I, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 2149/1 prot, datë 05.10.2023 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, për periudhën 2024 - 2026, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2659 / Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2023

V E N D I M

Nr. 24 , datë 13 . 11 . 2023

P Ë R

**DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT/TRANSFERTË E
PAKUSHTËZUAR PËR VITIN 2023**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 16, datë 17.07.2023 “Për miratimin e niveleve, klasave dhe grupeve të pozicioneve të punës, si dhe miratimin e strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të personelit administrativ dhe ndihmësakadmiq në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 6507/1 prot., datë 26.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 2659 prot., datë 13.11.2023,

VENDOSI:

1. Detajimin e fondeve buxhetore shtesë të akorduara për vitin 2023, në shumën 33.494.490 (tridhjetë e tre milion e katërqindë e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqindë e nëntëdhjetë) lekë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi në zërat:

-600 (paga të punonjësve)

-601 (sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve)

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2720 / Prot.
5

Tiranë, më 24 / 11 / 2023

V E N D I M

Nr. 25, datë 24 . 11 . 2023

P Ë R

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE” NË “INXHINIERI MATEMATIKE NË
AKTUARISTIKË” NË DEPARTAMENTIN E INXHINIERISË MATEMATIKE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK
2024-2025

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 21, datë 20.11.2023 të Senatit Akademik, si dhe relacionin e Administratorit nr. 2720/4 prot., datë 23.11.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë” në Departamentin e Inxhinierisë Matematike pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2024-2025.
2. Tarifa totale e shkollimit për këtë program studimi është 168.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2971 / Prot.
1

Tiranë, më 19 / 12 / 2023

V E N D I M

Nr. 26 , datë 19 . 12 . 2023

P Ë R

**MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË
PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË
INTEGRUAR TË STUDIMEVE, TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET E
PËRCAKTUARA, PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 2971 prot., datë 19.12.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 - 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur.
2. Për studentët që kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2023 – 2024, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.

3. Ky vendim t'i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2024.
 4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3036 / Prot.

Tiranë, më 26 / 12 / 2023

V E N D I M

Nr. 27 , datë 26 . 12 . 2023

P Ë R

MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT E VITEVE TË PARA QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, TË CILËT KANË PËRFUNDUAR ARSIMIN E MESËM TË LARTË ME NOTË MESATARE 9 - 10, PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 5339/8 prot., datë 19.12.2023 të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 3036 prot., datë 26.12.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët e viteve të para që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të

lartë me notë mesatare 9 – 10, për vitin akademik 2023 - 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur.

2. Për studentët e viteve të para që kanë përfunduar sistemin e arsimit të mesëm të lartë me notë mesatare 9 – 10, bursa financiare të paguhet nga fillimi i vitit akademik.
 3. Ky vendim t'i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2024.
 4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

